

# Kantoni i Basel-Landschaft

[Portret i shkurt](#)

[Sistemi politik](#)

[Feja](#)

[Koha e lirë](#)

## Portret i shkurt

Kantoni Basel-Landschaft është një nga 26 kantonet (shtetet federale) të Zvicrës. Karakterizohet nga diversiteti i tij i veçantë: Nga peizazhet natyrore të paprekura dhe qytetet e vogla simpatike, te kalatë dhe kështjellat e deri te zonat urbane industriale, gjithçka mund të gjendet në zonën e Baselit.

### Numrat dhe faktet

Kantoni Basel-Landschaft ka mbi 290.000 banorë, pothuajse një e katërta e të cilëve janë shtetas të huaj. Kantoni 518 km<sup>2</sup> përfshin 5 rrethe dhe 86 komunitete (komuna) rezidenciale. Kryeqyteti është Liestal. Gjuha zyrtare është gjermanishtja. Kantoni kufizohet me Gjermaninë dhe Francën dhe kantonet fqinje Basel-Stadt, Aargau, Solothurn dhe Jura.

### Historia

Kantoni Basel-Landschaft u themelua në 1832 si pjesë e ndarjes nga Basel-Stadt. Ditët e para të kantonit të ri u karakterizuan nga mosmarrëveshje politike dhe turbulenca ekonomike. Që herët, Basel-Landschaft u bë një vend strehimi për njerëzit nga e gjithë Evropa, veçanërisht nga Gjermania. Pas Luftës së Dytë Botërore, zona ekonomike e Baselit përjetoi një rritje të paprecedentë. Kantoni Basel-Landschaft regjistroi ritmet më të larta të rritjes në Zvicër dhe vazhdoi me zgjerimin e infrastrukturës së tij. Sot, kantoni i Basel-Landschaft është ende rural, por ka një industri me korporata të mëdha ndërkombëtare dhe shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (KMU) me fokus dhe udhëheqje globale në shkencat e jetës.

### Rite dhe tradita

Pavarësisht industrializimit ndonjëherë të fortë dhe urbanizimit, kantoni Basel-Landschaft karakterizohet nga një traditë e pasur dhe shumëngjyrëshe. Banorët vendas i ruajnë me entuziazëm traditat e tyre dhe do të jenë të lumtur nëse njiheni me këto festa dhe zakone. Përveç karnevaleve (Fasnacht), që janë shumë të rëndësishme në të gjithë rajonin dhe që zhvillohen në shkurt ose mars, edhe "Eierläset" për Pashkë ose "Banntag" në Ditën e Ngjitjes janë zakone tradicionale kantonale.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/portret-i-shkurt](http://www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/portret-i-shkurt)

## Sistemi politik

Fuqia politike në Zvicër është e ndarë në tri rrafshe. Konfederata, kantone (shtetet anëtare) dhe komuna. Zvicranet dhe zvicranët mundet të votojnë për ndryshimet politike.

### Shteti konfederativ i Zvicrës

Shteti konfederativ i Zvicrës ekziston prej 1848. Kryqyteti është Berni. Zvicra nuk përbën as etnikisht, as me gjuhë as me besim një unitet. Meqë kultura të ndryshme vullnetarisht janë bërë bashkë, flet njeriu për një nacionalitet dëshire (Willensnacion). Zvicra në politikën internacionale është shtet neutral.

### Federata

Në Zvicër kantonet dhe komunat kanë një pavarësi të madhe, njeriu flet për federatë. Të 26 kantonet dhe mbi 2000 komuna kanë plotësisht të ndërtuara strukturat shtetërore. Kantoni i Basel-Landschaft ka një kushtetutë të veten dhe një qeveri, një parlament dhe gjyqjet. Për shumë detyra shtetërore janë kantonet apo komunat përgjegjëse. Për këtë si shembull është sistemi shkollor prej kantoni në kanton i rregulluar ndryshe. Përgjatë ligjet shtetërore vlejné për gjithë Zvicrën, kantonet i kanë ligjet e veta, të vlejné vetëm për zonën kantonale. Edhe komunat mund t`i vëjnë rregullat e veta. Për përballimin e detyrave ngrejn kantonet dhe komunat si dhe konfederata tatimet.

## Ndarja e pushteteve

Për pengimin e koncentrimin të pushtetit, është pushteti shtetëror në Zvicër dhe në kantone i ndarë në tri pushtete të pavarura: Pushteti Legjislativ (pushteti legjislativ), Ekzekutiv (pushteti ekzekutiv) dhe Juridik (pushteti juridik). Në kantonin Basel-Landschaft zyrtarët i marrin këto detyra:

- Legjislativ: Këshilli i madh (Landrat) (90 anëtar, të zgjedhur nga populli çdo katër vjet)
- Ekzekutiv: Këshilli qeverisës (Regierungsrat) (5 anëtarë, të zgjedhur nga populli çdo katër vjet)
- Juridik: Gjyqje të ndryshme në rrafshin kantonial, si edhe gjykatat civile të rretheve civile

Edhe komunat kanë një legjislativ (mbledhje e komunës, parlament, (Gemeindeversammlung, Parlament) dhe një ekzekutiv (këshill qyteti apo komune, Stadtrat, Gemeinderat). Në rrafshin shtetëror legjislativi i ka dy dhoma: Nacional- dhe këshilli shtetëror (National-und Ständerat). Pushteti nacional (7 antëtarë) quhet këshilli konfederativ (Bundesrat). Edhe në rrafshin nacional ekzistojn gjyqje të ndryshme. Në gjyqin konfederal si instanca më e lartë mund të dërgohen p.sh. vendimet gjyqësore të kantonit.

## E drejta demokratike

Të drejtat themelore më të larta në Zvicër janë të shkruara në kushtetutën konfederative (Bundesverfassung). Një pjesë e rëndësishme e kushtetutes konfederative janë të drejtat themelore, të cilat bazohen në konventën evropiane për të drejtat e njeriut (KEDN). Ato mbrojnë ekzistencën e njeriut (p.sh. e drejta për jetë, e drejta për ndihmë në situata emergjente) dhe mbrojnë individin kundër dhunës shtetërore apo grupet kundër shumicës. Ato garantojnë, që askush për shkak vendit të ardhjes, rases, besimit, gjinisë apo drejtimit seksual të mos diskriminohet. Viktimat prej diskriminimit racor marrin në kantonin e Basel-Landschaft mbështetje dhe këshillim falas. Në Zvicër mbretrojnë liria e besimit, mendimit dhe shtypit. Përveç kësaj, shpesh ekziston mundësia për t'u përfshirë në komisione, grupe interesi ose klube në vendbanimin.

## **E drejta themelore**

Të drejtat themelore më të larta në Zvicër janë të shkruara në kushtetutën konfederative (Bundesverfassung). Një pjesë e rëndësishme e kushtetutes konfederative janë të drejtat themelore, të cilat bazohen në konventën evropiane për të drejtat e njeriut (KEDN). Ato mbrojnë ekzistenzen e njeriut (p.sh. e drejta për jetë, e drejta për ndihmë në situata emergjente) dhe mbrojnë individin kundër dhunës shtetërore apo grupet kundër shumicës. Ato garantojnë, që askush për shkak vendit të ardhjes, rases, besimit, gjinisë apo drejtimit seksual të mos diskriminohet. Viktimat prej diskriminimit racor marrin në kantonin Basel-Landschaft mbështetje dhe këshillim falas. Në Zvicër mbretrojnë liria e besimit, mendimit dhe shtypit.

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/sistemi-politik](http://www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/sistemi-politik)

## Feja

Zvicra është tradicionalisht një vend i krishterë. Sot jetojnë në Zvicër edhe shumë pjestarë që i përkasin një shoqërie tjetër fetare. Liria fetare është e garantuar dhe shkollat e shtetit për fe janë neutrale.

### Feja dhe shteti

Zvicra është tradicionalisht e karakterizuar me fenë e krishterë. Qëndron në përgjegjësin e kantoneve, që t`i përcaktojnë marrdhëniet e fes me shtet. Në shumicën e kantoneve gjermanozviceran, si dhe në kantonin Basel-Landschaft, shoqëria fetare e krishterë është e pranuar si institucione publike-juridike (Kishat shtetërore, Landeskirchen). Kjo do të thotë, që shteti atyre ju bart disa të drejta. Konkretisht munden p.sh. prej pjestarëve të tyre të marrin tatim. Në kantonin Basel-Landschaft janë kishat römisch-katolike , ajo e reformuar dhe kristianekatolike si kisha shteti.

### Shoqërit fetare në kantonin Basel-Landschaft (DE)

Pran shoqërive fetare (kishave shtetërore) zyrtarisht të pranuar ka në kantonin Basel-Landschaft edhe shoqëri tjera të shumta fetare me besime të ndryshme. Shumica e banoreve dhe banorëve të Basel-Landschaft i takojnë besimit të krishterë. Megjithatë, vitet e fundit është rritur edhe numri i anëtarëve të besimeve të tjera. Dhe përqindja e banorëve që nuk ndiejnë se i përkasin ndonjë besimi fetar po rritet gjithashtu

### Liria fetare

Kushtetuta e Zvicrës garanton lirit fetare. Secili ka të drejtë, ta ketë një besim fetar, këtë besim ta shpreh dhe ta përhap. Askush nuk mund të detyrohet, të hyj në një shoqëri fetare apo të marr pjesë në veprimet e tyre. Personat mund të mblidhen për me festue ritualet fetare. Askush nuk guxon të diskriminohet për shkak të fesë apo besimit të tij.

### Feja dhe shkolla

Shkolla e detyruar është për nga feja neutrale. Kjo nuk do të thotë, që temat religjioze nuk kanë vend në mësim. Dallimi bëhet në mes dy llojeve të mësimit për religjionin. Mësimi për fenë i kishave shtetërore dhe mësimi shkollor për besimin "Etika dhe Religjioni". Në këtë lëndë tematizohen pyetjet fetare dhe etike që u përkojnë tërë njerëzve. Në shkollën fillore të uët dhe në vitin e 1. të lartë është një lëndë e detyrueshme. Pjesëmarrja në mësimin rrëfyet fetar në kishat shtetërore është vullnetare. Për fëmijët me besim tjetër ofrojnë shoqërit fetare pjesërisht mundësi për mësim fetar jashtë shkollës.

**Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/feja](http://www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/feja)

## Koha e lirë

Në kantonin Basel-Landschaft ka mundësi të shumta atraktive për ta kaluar kohën e lirë. Një domethënje të madhe kanë shoqatat. Këto ofrojnë mundësi për të njohur njerzë të tjerë.

### Shoqatat

Shumë banore dhe banorë të kantonit Basel-Landschaft janë anëtarë në një shoqatë (Verein). Ka shumë shoqata për interesa të ndryshme. Edhe në komuna të vogla ekzistojnë shoqata për sport-, kulturë dhe të tjera. Ato ofrojnë mundësi ideale për me ra në kontakt me njerzë të tjerë. Shumica e shoqatave janë për të gjithë personat të hapura. Informacione për shoqata, gjinden edhe në faqet e internetit të komunave.

### Ofertat për të rinjë

Për të rinjë ka në kantonin Basel-Landschaft shumë oferta specifike, për ta kaluar kohën e lirë dhe me njoftë bashkëmohatar. Në shumë komuna ka pikëtakime dhe oferta të ndryshme për ta kaluar kohën e lirë. Të rinjë janë nën përkujdesje, mundën me i sjell idetët dhe me i zbatue projektet e tyre (Jugendarbeit). Ofertat janë zakonisht falas. Shoqatat për të rinjë ofrojnë mundësin, që s`bashku me bashkëmohatar të ndërmarrin aktivitete dhe të ushtrojnë sport në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, komunat apo kishat e vendit. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjë. Komuna jep njoftime të tjera.

### Shëtitjet dhe kultura

Kantoni Basel-Landschaft ofron mundësi të shumta për shëtitje dhe një ofertë të pasur kulturore. Ka shumë itinerare të bukura për ecje dhe çiklizëm në peizazhin unik të Jurës. Destinacionet e njohura të ekskursionit përfshijnë qytetin romak Augusta Raurica, rajonin "Wasserfallen" ose kështjellat dhe kalatë e shumta që i përkasin kantonit të Basel-Landschaft, ashtu si edhe Rhein ose Birs. Turizmi Baselland ofron informacion mbi ekskursionet dhe ngjarjet. Informacione mbi ngjarjet aktuale kulturore mund të gjenden gjithashtu në gazetata lokale.



## **Puna vullnetare**

Puna vullnetare (Freiwilligearbeit) është një kontribut i shoqërisë për njerëzit dhe ambientin e cila nuk paguhet. Detyra të shumta merren tradicionalisht prej vullnetarëve. Një pjesë e madhe e punës bëhet në shoqata. Kështu mundet njeriu të angazhohet në shoqatat për kulturë, sport, interesa sociale, arsimim, për mbrojtjen e kafshëve dhe ambientit, shëndetësi dhe fusha të tjera. Informacione për punën vullnetare dhe mundësit e nevojshme japin agjensit e specializuara për punë vullnetare Benevol, Kryqi i Kuq Zvicerian Baselland ose Caritas beider Basel.

## **Sporti / Kultura / Arsimimi**

Me Kulturlegi- Letërnjoftim kanë njerëzit me pak para, lirim për sport-kultur- dhe veprimtari arsimore. Për këtë letërnjoftim mund të bëhet kërkesa në Caritas. Caritasi informohet dhe vërteton. A ka njeriu të drejtë të ketë Kulturlegi. Si një ofertë tjetër, pasaporta familjare (Familienpass) u ofron familjeve në Zvicrën veriperëndimore një gamë të gjerë zbritjesh ose ofertash falas. Ka gjithashtu zbritje të shumta dhe oferta falas për fëmijë, adoleshent dhe të rinj, të tilla si "colourkey" ose pasaporta e pushimeve (Ferienpass). Detajet mund të gjenden në faqet e ofertës në internet.

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/koha-e-lire](http://www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/koha-e-lire)